

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Lac më dt.12.11.2021.

VENDIM

“ Për kalim në pronësi të kreditorit të sendeve të luajtshme”

Në Lac, sot me dt.12.11.2021,

Une, Mikeda Cenaj, me detyrë Përmbauese Gjyqësore, pranë Zyrës Përmbauese Kurbin, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbauese Nr. 23/CP011020190001 rregj. të vitit 2021 bazuar në Urdhërin e ekzekutimit Nr. 1053-229 të datës 16.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se në datë 30.09.2019 është regjistruar pranë Zyrës së Përmbaimit Kurbin kërkesa për vënie në ekzekutim të detyruar nga pala kreditore Prek Gjoke Stakaj, për ekzekutimin e urdhërit ekzekutiv të sipërcituar të lëshuar për ekzekutim të detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor civil) nr. 563-174 date 08.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar me datë 17.06.2019, me palë dhe objekt si më poshtë:

- Kreditor : Prek Gjoke Stakaj me banim në Tiranë
- Debitor : AMN-GROUP ALBANIA Sh.p.k me nipt L77524301J dhe adm. Z. Altin Selmanaj.
- Me objekt-Zgjidhjen e kontratës së qerasë nr. 421 rep, nr. 281 kol. dt.14.02.2017

-Detyrimin e palës së paditur që të paguajë qiratë e papaguara prej muajit maj 2017 dhe janar 2018 e deri në lirim dhe dorëzimin e sendit në vlerën prej 38928 (tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) euro si dhe 3000 euro (tremijë) euro në muaj deri në momentin e lirit dhe dorëzimit të sendit konkretisht deri në datën që është bërë liri dhe dorëzimi më datë 17.01.2021 është në vlerën 63828 (gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e tetë) euro

-Detyrimin e palës së paditur që të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e furnizimit me energji elektrike, konkretisht kontrata E100711 në emër të paditësit Prek Stakaj deri në momentin e dorëzimit të sendit, konkretisht në vlerën prej 782360 (shtatëqind e tetëdhjetë e dymijë e treqind e gjashtëdhjetë) leke si dhe vlera e energjisë elektrike që do të faturohet për këtë objekt deri në lirim dhe dorëzimin e sendit.

-Lirim dhe dorëzimin e sendit me nr. 46/34/1 pasurie volum 18 faqe 89 lloji truall me sipërfaqe ndërtese 1028 m² e regjistruar në ZVRPP KURBIN në emër të Prek Stakaj e Domenika Stakaj.

-Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestrimin mbi sendet e luajtshme në pronësi të shoqërisë AMN Group shpk e përfaqësuar nga administrator Altin Selmanaj të ndodhura në objektin e dhënë me qera në adresën autostrada Mamurras-Lezhe, pasuria nr. 46/34/1 ZK1812 dhënë prej paditësit Prek Stakaj

-Tarifa fikse përmbauese dhe tvsh-ja e saj në masën 281147 lekë + 174000 lekë shpenzime ekzekutimi për ekspertet e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, gjithsej 455147 (katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë enjëqind dyzet e shtatë) lekë;

Në vijim të procedurave ekzekutivo-përmbauese të parashikuara në kapitullin e fundit të Kodin e Procedurës Civile janë kryer veprimet përkatëse për ekzekutimin e urdhërit ekzekutiv të sipërcituar dhe në kushtet kur pala debitore, pas marrjes dijeni, nuk e ka përmbushur detyrimin vullnetarisht, është proceduar me ekzekutim të detyrueshëm duke urdhëruar vendosjen e sekuestros konservative pranë Bankave të nivelit të dytë, pranë Z.V.A.SH.K Kurbin, pranë D.R.SH.T.Rr Lac, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Lezhë dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë si

dhe janë kryer veprimet procedurale për ligjërimin e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestron ekzekutive mbi sendet e luajtshme në pronësi të shoqërisë AMN Group shpk e përfaqësuar nga administrator Altin Selmanaj të ndodhura në objektin e dhënë me qera në adresën autostrada Mamurras-Lezhe ,pasuria nr. 46/34/1 ZK1812 dhënë prej paditësit Prek Stakaj.

Tifulli ekzekutiv,vendimi gjyqësor nr. 563-174 date 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin,që ka marrë formë të prerë me datë 17.06.2019,ndër të tjera pervec disponimit lidhur me detyrimet në vlerë monetare dhe lirimit e dorëzimit të sendit të paluajtshëm ka vendosur edhe ligjërimin e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestrimin mbi sendet e luajtshme në pronësi të shoqërisë AMN Group shpk e përfaqësuar nga administratori Altin Selmanaj, të ndodhura në objektin e dhënë me qera në adresën autostrada Mamurras-Lezhë ,pasuria nr. 46/34/1 ZK1812 dhënë prej paditësit Prek Stakaj,si rrjedhojë në vijim pas kryerjes së disa veprimeve përmbartimore kemi proceduar vlerësimin e tyre me ekspert të licencuar pasi nuk u bë e mundur me marrëveshje ndërmjet palëve dhe përmbartuesit gjyqësor caktimi i çmimit të sendeve të luajtshme të sekuestruara.

Në vijim është proceduar me dy ankandet publike për shitjen e këtyre sendeve nga ku është konstatuar që përgjatë kohëzgjatjes së shpalljes publike dhe ditëve të zhvillimit të ankandëve publike nuk ka patur zyrtarisht asnjë ofertues dhe si rrjedhojë kur çmimi me të cilin ka filluar ankandi i dytë publik ka qënë 2.827.440 (dymilion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet)lekë ,vlerë kjo e cila nuk e përmbushte të gjithë detyrimin e kësaj pale debitore për dy çështjet përmbartimore të regjistruara në Zyrën tone, si rrjedhojë në zbatim të nenit 534,535,537 e vijues të K.Pr.Civile kemi proceduar me hartimin e projektit të ndarjes së shumave me vendimin përmbartimor nr.782 prot date 24.02.2021.Ndarja e shumave është përfundimtare sepse është shpallur dhe është publikuar për jo më pak se 20 ditë sic parashikon neni 133/b i Kodit të Procedurës Civile për palën debitore si dhe rezulton se nga palët kreditore dhe debitore nuk është depozituar/ ushtruar ankim ndaj projektit te ndarjes sw shumave në Gjykatën e vëndit të ekzekutimit,pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin ,e konfirmuar kjo me shkresën nr. 5050 prot datë 19.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Palës kreditore "The Star " Shpk me shkresën nr. 3660 prot datë 31.09.2021 i janë propozuar sëndet e luajtshme takuese për t'u marrë në pronësi dhe brenda afatit ligjor kjo palë kreditore na ka njoftuar zyrtarisht me shkresën e saj datë 05.10.2021 se nuk pranon marrjen në pronësi të sendeve të propozuara dhe në këto rrethana i kemi propozuar mbështetje të nenit 557,559 tw K.Pr.Civile kreditorit Prek Stakaj qe të marrw në pronësi sëndet e luajtshme qe nuk ishin pranuar nga kreditori The Star Shpk , objekt sekuestrimi dhe ekzekutimi përkundrejt kredisë me çmimin me të cilin ka filluar ankandi i dyte publik për secilin nga sendet e luajtshme në vlerën takuese prej 1747 (njëmijë e shtatëqind e dyzet e shtatë)euro dhe rezulton se pala kreditore me shkresën e tij të datës 01.11.2021 ka pranur shkresërisht marrjen e këtyre sëndeve në pronësi,si rrjedhojë në këto kushte duhet që të kalohet e pronësia e sendeve të luajtshme të propozuara në pronësi të kreditorit Prek Stakaj me shkreswn tonw nr. 4463 prot datw 27.10.2021.

PËR KËTO ARSYE

Zyra e Përmbartimit Kurbin bazuar në nenin 557,559 të K.Pr.Civile,nenit 141 e vijues të Kodit Civil si dhe ligjit nr.8730 dt. 18.01.2001"Për Funksonimin dhe Organizimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor"të ndyshuar

URDHËROJ

1-Kalimin e pronësisë në favor të palës kreditore Prek Gjoke Stakaj, për pasurinë/sendet e luajtshme të propozuara me shkresën tonw nr. 4463 prot datë 27.10.2021 si më poshtë vijon:
- 1(një copë) makinë hekurosje me të dhënat ROTONDI , kafe+jeshile, C15-013 + hekur, me vlere 17000(shtatëmbëdhjetëmijë)lekë sipas ankandit te dytë;
-1(një copë) makinë hekurosje me të dhënat ROTONDI , kafe+jeshile, C15-020 + hekur me vlere 17000(shtatëmbëdhjetëmijë)lekë sipas ankandit te dytë;
-1(një copë) makinë hekurosje me të dhënat ROTONDI , kafe+jeshile, C15-001 + hekur, me vlere 17000(shtatëmbëdhjetëmijë)lekë sipas ankandit te dytë;
-1(një copë) Makineri qepese STROBEL per qepje te padukshme, KL -45-123, ngjyre gri, model 96004-5, me motorr, nuk eshte provuar nese funksionon me vlere 4760(katërmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë) Makineri qepese STROBEL per qepje te padukshme, Class 58-4, KL - 45 -133, ka motorr, e viteve 1970-1975, ngjyre gri me vlere 3400(tremijë e katërqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë)Makineri qepese per vrimat, me numer model 104, marca REECE, Hollandeze, ngjyre qumeshti, viti1987, 3334-5/1 me vlere 27200(njëzet e shtatë mijë e dyqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë) Makineri qepese PFAFF per qepje zig zag, klas 437, numer social 901-0437-016/002, ngjyre bezhe dhe kafe, ndizet, funksionon dhe ne gjendje teknike te mire me vlere 13600(trembëdhjetë mijë e gjashtëqind)lekë sipas ankandit te dytë;;

-1(një copë) Makineri qepese PFAFF, model i vjeter numer 213992, klass 481-06/01, 900/51-BS, per qepje lineare, gri, dopio transport, ndizet, funksionon dhe ne gjendje teknike te mire me vlere 13600(trembëdhjetë mijë e gjashtëqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë) Makineri qepese PFAFF per qepje lineare, me klas 483, numer 901-0483-003/003, numer 287597, ngjyre bezhe+kafe, ndizet, funksionon dhe ne gjendje teknike te mire me vlere 13600(trembëdhjetë mijë e gjashtëqind)lekë sipas ankandit te dytë;;

-1(një copë) Makineri qepese TYPICAL, per qepje lineare, klas GC6180ME2(motori), bardhe, prodhim i viteve '97-2000, jeshile tavolina, ndizet, funksionon dhe ne gjendje teknike te mire me vlere 13600(trembëdhjetë mijë e gjashtëqind)lekë sipas ankandit te dytë;;

-1(një copë) Makineri qepese TYPICAL, per qepje lineare, klas GC6180ME2(motori), bardhe, prodhim i viteve '97-2000, jeshile tavolina, ndizet, funksionon dhe ne gjendje teknike te mire me vlere 13600(trembëdhjetë mijë e gjashtëqind)lekë sipas ankandit te dytë;;

-1(një copë) Makineri qepese DURKOPP, qepje lineare, numer 610372, nuk vihet ne pune, nuk funksionon motorri, ngjyre gri me vlere 3400(tremijë e katërqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë) Makineri PFAFF, model 463-34/01, numer 1377096, 900/99 BS, pa prerje motorr, e thjeshtë, ndizet, funksionon dhe në gjendje teknike të mirë me vlere 6800(gjashtë mijë e tetëqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë) tavoline hekurosje AJTEC srl,France me vlere 13600(trembëdhjetë mijë e gjashtëqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-1(një copë) tavoline hekurosje me hekur, blu , C15-005 me vlere 20400(njëzet mijë e katërqind)lekë sipas ankandit te dytë;

-16(gjashtembëdhjetë copë)karrela në formë trekendore metalike - metalike, me ngjyre gri, jeshile, me gjatesi 125cm, bazë të trekendeshit 55 cm, lartesi 160 cm me vlere 16576(gjashtembëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë)lekë sipas ankandit te dytë.

2-Palës kreditore sendet e luajtshme të sipërpërshkruara i kalohen në pronësi përkundrejt kredisë në vleren 1747 (një mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë) euro, i konvertuar me kursin ditor të këmbimit sipas Bankes së Shqipërisë, vlerë kjo që i korrispondon cmimit total të sendeve të luajtshme, me të cilin ka filluar ankandi i dytë publik për shitjen e tyre me njoftimin nr.282 prot datë 01.02.2021 .

3- Ky vendim mbahet në tre kopje ,ku njeri qëndron në dosjen përmbartimore dhe kopjet e tjera në original u komunikohen palëve në proces.

U shpall në Lac sot me dt.12.11.2021.

PERMBARUES GJYQESORE
MIKEDA CENAJ

